

Vendim nr. 240, datë 14.07.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 14.07.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 36 (A) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ABUSH BEADINI**, përfaqësuar nga avokatët Blerta Nikolli dhe Aleks Nikolli, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr.128, datë 28.09.2020 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2025-1641, datë 04.11.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ose në Gjykatën e Lartë, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: **Nenet 18, 41, 42, 115, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, 141 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe neni 1 i Protokollit nr.1 të saj; nenet 27, 39, 45, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë “Beadini” sh.p.k., me seli në Shëngjin, Lezhë, që ka për objekt veprimtarie, ndër të tjera, edhe shitblerjen e pasurive të paluajtshme. Në datën 10.09.2013 kërkuesi ka lëshuar një prokurë të përgjithshme me të cilën ka emëruar si përfaqësuese shtetasen M.M., duke i dhënë asaj të drejtën që, në emër dhe për llogari të tij si individ dhe të shoqërisë së tij të blinte pasuri të paluajtshme në Shqipëri, duke e autorizuar të nënshkruante aktet noteriale të shitblerjes, t’i regjistronte ato në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të tërhiqte dokumentet e pronësisë për pasuritë e blera. Me anë të kësaj prokure, gjatë viteve 2013-2014, shtetasja M.M. ka blerë disa pasuri të paluajtshme, kryesisht në zonën Shëngjin-Lezhë, për llogari të kërkuesit, ndërsa ky i fundit dhe familjarë të tij i kanë transferuar ose dorëzuar kësaj shtetaseje vlera monetare për të bërë pagesat e blerjeve.

2. Në datën 26.02.2015 kërkuesi, në cilësinë e administratorit të shoqërisë “Beadini” sh.p.k., ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë (*Prokuroria e Lezhës*) kundër shtetasës M.M. dhe bashkëshortit të saj, shtetasit F.M., të cilët, sipas kallëzuesit, kanë kryer veprën penale “Mashtrimi”, me pasoja të rënda, ndërsa disa nga pasuritë e blera nuk kanë kaluar në pronësi të kërkuesit, pavarësisht se e kallëzuara M.M. ka marrë vlerën e çmimit nëpërmjet dokumenteve fiktive të prezantuara prej saj. Në vijim, ndaj këtyre shtetasve është regjistruar procedimi penal, duke u akuzuar për veprën penale “Mashtrimi”, në rrethana cilësuese (me pasoja të rënda), të parashikuar nga neni 143, paragrafi 2, i Kodit Penal (KP), për të cilën janë dërguar për gjykim. Në përfundim të procesit gjyqësor, shtetasja M.M. është dënuar me 4 vjet burgim, ndërkohë që në aplikim të nenit 59 të KP-së është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të dënimit të saj, ndërsa të pandehurin F.M. gjykata e apelit e ka shpallur të pafajshëm, duke arsyetuar se nuk provohet se ai ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet (*procesi i parë*).

3. Në vijim të kallëzimit të parë, kërkuesi ka paraqitur në Prokurorinë e Lezhës një kallëzim të ri penal me nr. 674, datë 16.06.2017, mbi të cilin është regjistruar procedimi penal nr.515 i vitit 2018 kundër shtetasve M.M dhe F.M., me pretendimin se gjatë gjykimit civil të

zhvilluar mes tyre janë zbuluar fakte të reja për përvetësime shumash të tjera, për blerjen për llogari të tij të pasurive të paluajtshme nr.3/623, me sipërfaqe 439 m², dhe nr.3/624, me sipërfaqe 439 m², të ndodhura në fshatin Ishull Shëngjin, Lezhë.

4. Pas hetimeve të kryera, Prokuroria e Lezhës e ka dërguar çështjen për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, duke vlerësuar se shtetasit e akuzuar kanë vepruar në mashtrim ndaj kallëzuesit kërkues, për sa kohë është provuar se shtetasja M.M. ka tërhequr shumat që kërkuesi ose familjarë të tij kanë transferuar në llogarinë e saj në bankën “Credins” sh.a., duke specifikuar se arsyeja e transfertave ishte blerja e pasurive. Po kështu, përveç tërheqjes së shumave në llogarinë bankare, shtetasja M.M. ka nënshkruar një faturë nga ku ka rezultuar se ka marrë shumë tjetër për blerjen e pasurive të paluajtshme, objekt i kontratave, ku nuk paraqitet çmimi real. Gjithashtu, ka rezultuar se bashkëshorti i saj ka pasur dijeni për veprimet e saj dhe, në bashkëpunim me të, ka vepruar në arritjen e qëllimit, përvetësimin e pasurisë së kërkuesit.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 251, datë 18.10.2019, ka vendosur deklarinimin fajtorë të shtetasve M.M. dhe F.M. për veprën penale “Mashtrimi”, të parashikuar nga neni 143/2 i KP-së, për të cilën akuzoheshin, si dhe dënimin e tyre respektivisht me 5 vjet burgim. Për sa i përket faktit penal, gjykata e shkallës së parë ka pranuar se e pandehura M.M., në cilësinë e përfaqësueses me prokurë të përgjithshme të kërkuesit, ka kryer veprime të kundërligjshme duke e mashtruar këtë të fundit dhe duke përvetësuar një shumë prej 330.153 frangash nëpërmjet shpërdorimit të besimit dhe abuzimit me shumat e kaluara vullnetarisht në llogari bankare ose të dhëna *cash* në dorë nga kërkuesi, duke mos ia kthyer më. Sipas gjykatës së shkallës së parë, ndonëse e pandehura ka nënshkruar kontrata të rregullta për blerjen e pasurive të paluajtshme, çmimet e tyre kanë rezultuar të jenë fiktive. Sipas asaj gjykate, edhe i pandehuri tjetër ka pasur dijeni për veprimet e kundërligjshme dhe ka bashkëpunuar me bashkëshorten e tij në kryerjen e vjedhjes nëpërmjet mashtrimit. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë kanë paraqitur ankim të pandehurit, duke kërkuar prishjen e tij.

6. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.128, datë 28.09.2020, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e çështjes për shkak se me vendimin e formës së prerë të pandehurit janë gjykuar për të njëjtin fakt penal në procesin e parë. Sipas gjykatës së apelit, mbi bazën e të dhënave të faktit, të dyja proceset gjyqësore kanë pasur për objekt të njëjtin fakt penal, pasi është konstatuar se e pandehura, përfaqësuese e kërkuesit, me prokurën e datës 10.09.2013, ka shpërdoruar besimin e tij për blerjen e disa pasurive duke lidhur kontrata

fiktive e duke përvetësuar në bashkëpunim me bashkëshortin e saj, përgjatë harkut kohor 2013-2014, shuma në vlerën 330.153 franga të dërguara nga kërkuesi, duke u akuzuar e dënuar për veprën penale “Mashtrimi”. Ky përfundim, sipas gjykatës së apelit, është pohuar edhe në arsyetimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, i cili, bazuar në vendimin unifikues nr.2, datë 03.11.2014 (*vendimi nr.2/2014*) të Gjykatës së Lartë, si dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), ka konkluduar se vendimi i gjykatës së apelit në procesin e parë është ende në shqyrtim në Gjykatën e Lartë për shkak të rekursit nga palët ndërgjyqëse dhe, si i tillë, nuk përbën gjë të gjykuar. Gjykata e apelit ka vlerësuar se bazuar në parimin *ne bis in idem*, ndalimi i gjykimit dy herë për të njëjtin fakt, i përcaktuar në nenin 7 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), shtrihet edhe në vendimet që kanë marrë formë të prerë, sikurse vendimi i gjykatës së apelit në procesin e parë. Sipas gjykatës së apelit, ndryshe nga arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë, vendimi unifikues nr.2/2014 i Gjykatës së Lartë nuk gjen zbatim në rastin në shqyrtim, pasi dispozitat kushtetuese e procedurale kanë ndryshuar, duke bërë që ky vendim mos të ketë fuqi detyruese të zbatimit, sepse, së pari, nuk ka njëzuar ose zhvilluar një praktikë gjyqësore dhe, së dyti, ligjvënësi, me reformimin e KPP-së, ka përcaktuar se vendimi i formës së prerë është vendimi i gjykatës së apelit kur zgjidh përfundimisht çështjen. Në përfundim, gjykata e apelit ka vlerësuar se në rastin në shqyrtim vepron parimi *ne bis in idem*, pasi gjykata e shkallës së parë ka gjykuar të njëjtat veprime dhe të njëjtat pasoja të shkaktuara nga të njëjtët të pandehur që ka gjykuar edhe më parë, edhe pse cilësimi i tyre ligjor është i ndryshëm. Kundër vendimit të gjykatës së apelit kanë ushtruar rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Shkodër dhe kërkuesi, duke kërkuar prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

7. Me vendimin nr. 00-2025-1641, datë 04.11.2025, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të prokurorisë, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Sipas Gjykatës së Lartë, ndonëse gjykatat e faktit kanë mbajtur qëndrime të ndryshme, gjykata e apelit ka argumentuar në mënyrë shteruese vendimmarrjen e saj, duke konstatuar se të pandehurit janë gjykuar për të njëjtin fakt penal. Për sa i përket pretendimit në rekurs, se gjykata e shkallës së parë është bazuar në fakte e në prova, të cilat nuk janë përdoruar në gjykimin e parë, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se në të dyja aktakuzat e Prokurorisë së Lezhës është specifikuar fakti i mashtimit për të përvetësuar pasuritë monetare të së njëjtës viktimë për blerjen e të njëjtave pasuri, si dhe mënyra dhe koha në të cilat janë marrë, për rrjedhojë ajo mbështetet në konkluzionin e arritur nga gjykata e apelit se fakti penal është një

dhe i vetëm, i kryer në të njëjtën periudhë nga e pandehura M.M. dhe për të njëjtin qëllim, përvetësimin e pasurisë së kërkuesit. Po kështu, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se kërkuesi nuk është subjekt i legjitimuar nga ligji procedural penal për të paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, pasi vepra penale e mashtrimit, objekt i gjykimit, është nga ato vepra penale që ndiqen kryesisht nga organi i akuzës, i cili kryen hetimin dhe mbart barrën e provës e në këtë rast ligji procedural penal të drejtën e ankimit ndaj vendimit përfundimtar ia ka njohur prokurorit, i cili mbron akuzën në gjykim dhe njëkohësisht të drejtat ligjore të viktimës ose të trashëgimtarëve të saj.

8. Në datën 08.05.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuesit

9. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

9.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

9.1.1. *Parimit të paanshmërisë*, pasi Kolegji Penal, që ka shqyrtuar rekursin e kërkuesit dhe të Prokurorisë së Lezhës, në të dyja proceset gjyqësore ka pasur të njëjtën përbërje duke u ndodhur në kushtet e papajtueshmërisë, të parashikuar nga neni 15 i KPP-së. Në gjykimin e parë, trupi gjykues i Gjykatës së Lartë ka marrë në shqyrtim akuzën dhe fajësinë e të pandehurve, ndaj i njëjti trup gjykues në procesin e dytë gjyqësor nuk mund të shqyrtonte sërish të njëjtën çështje për të njëjtin fakt penal, sikurse është shprehur vetë Gjykata e Lartë në vendimin e saj.

9.1.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit* gjyqësor, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimmarrjen e tij ka bërë një trajtim ritual formal të pretendimeve të kërkuesit dhe të Prokurorisë së Lezhës, pa i marrë ato në analizë konkrete për t'u dhënë përgjigje ligjore. Gjykata e Apelit Shkodër është marrë vetëm me trajtimin doktrinar dhe jurisprudencial të parimit *ne bis in idem*, ndërkohë nuk ka marrë në analizë faktet e ndryshme penale të gjykuara në procesin e parë gjyqësor nga ato objekt gjykimi në procesin e dytë gjyqësor. Mashtrimi objekt i procesit të dytë gjyqësor ka në thelb fakte të reja për të cilat kërkuesi ka marrë dijeni dy vjet pas kallëzimit të parë

penal, më konkretisht gjatë zhvillimit të gjykimit civil, ku është mësuar se kërkuksi, megjithëse kishte paguar shumë prej 330.153 frangash zvicerane për blerjen e dy pasurive me sipërfaqe totale 878 m² dhe të ndërtesës mbi të, të pandehurit jo vetëm nuk ia kanë dorëzuar kërkuksit, por nëpërmjet kundërpadsisë në procesin civil kanë pretenduar pronësinë e tyre.

9.2. *E drejta e pronës private*, pasi ndonëse është provuar qartësisht se kërkuksit i është shkaktuar dëm i madh ekonomik dhe financiar nga veprimtaria kriminale e të pandehurve, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë refuzuar në mënyrë të paarsyetuar mbrojtjen e drejtave pronësore të kërkuksit, viktimë e veprës penale “Mashtrimi”.

III

Vendimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuksit

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara nga neni 71/a i Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kriterë janë të natyrës kumulative, pra duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej këtyre kriterëve që kërkuksi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

11. Lidhur me legjitimimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, Gjykata ka pohuar në jurisprudencën e saj se kërkuksi duhet të provojë legjitimitetin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo, sepse individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të

drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga masa/akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimin nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Kolegji vëren se në çështjen në shqyrtim kërkuesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor, në përfundim të të cilit është vendosur pushimi i çështjes penale ndaj dy të pandehurve M.M. dhe F.M., në lidhje me akuzën publike të ngritur ndaj tyre nga organi i prokurorisë, për kallëzimin e kërkuesit për veprën penale “Mashtrimi”, të kryer në bashkëpunim, dhe me pasoja të rënda, të parashikuar nga neni 143, pika 2, i KP-së. Kërkuesi ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të paanshmërisë dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe të drejtën e pronës private.

13. Duke marrë shkas nga pretendimet e ngritura nga kërkuesi, Kolegji çmon të evidentojë fillimisht se neni 148, pika 1, i Kushtetutës parashikon: *“Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit.”*. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se nga përmbajtja e kësaj dispozite rrjedh se ndjekja penale është detyrë ekskluzive e shtetit dhe se për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar ngritjen e një organi të posaçëm për ushtrimin e ndjekjes penale në shërbim të mbrojtjes së interesave të shtetit dhe të shoqërisë. Ajo ka theksuar se organi i prokurorisë ka si funksion kryesor ushtrimin e ndjekjes penale në emër të shtetit dhe përfaqësimin e akuzës publike në gjyq dhe se, përveç asaj, asnjë organ tjetër nuk është i autorizuar për ushtrimin e këtyre funksioneve. Po kështu, Gjykata ka theksuar se një nga funksionet kryesore të shtetit të së drejtës është respektimi i kuadrit normativ nëpërmjet sigurimit të një drejtësie penale funksionale dhe se ndjekja penale që zhvillohet mbi bazën e akuzës publike duhet të jetë e mbështetur në dispozita ligjore të përcaktuara saktë (*shih vendimin nr. 3, datë 06.02.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Po kështu, Kolegji çmon të evidentojë se edhe ligji procedural penal ka parashikuar subjektet e procesit penal, ndër të tjera, edhe atë të viktimës së veprës penale (neni 58 i KPP-së). Në kuadër të ndryshimeve që KPP-ja ka pësuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017, pozita e viktimës së veprës penale ka pësuar ndryshime në drejtim të zgjerimit të së drejtës së aksesit, duke parashikuar shprehimisht për atë një sërë të drejtash procedurale, qoftë në fazën e hetimit paraprak, ashtu edhe në gjykimin e çështjes penale. Ashtu sikundër ka arsyetuar edhe Gjykata e Lartë, referuar ligjit procedural penal, pavarësisht se viktimja e veprës penale është pjesëmarrëse në procesin penal, pozita e saj nuk paraqitet e njëjtë me atë të prokurorit ose të të pandehurit, që,

krahas gjykatës, janë subjektet kryesore në një proces penal që mund të fillojë edhe kryesisht për ato vepra penale që mbartin në vetvete rrezikshmëri jo të vogël, nisur kjo nga interesi i lartë publik në ushtrimin e ndjekjes penale. Në këto raste, interesi privat i viktimës së veprës penale përthithet nga interesi publik, ndaj përfaqësimi i akuzës publike në gjyq është përcaktuar nga ligjvënësi si tagër vetëm i organit të prokurorisë, duke i njohur atij edhe të drejtën e ankimit në gjykatat më të larta kundër një vendimi gjyqësor që ka vendosur në themel për fajësinë ose pafajësinë e një personi të akuzuar, të drejtë të cilën nuk ia ka njohur viktimës nga vepra penale.

15. Nga sa më lart, Kolegji vëren se ndonëse kërkuesi ndodhet në pozitën e viktimës, të parashikuar nga neni 58 i KPP-së, ai nuk është palë në procesin penal në pozita të njëjta me prokurorin ose të pandehurit, për pasojë ai nuk mund të ketë legjitimim për të ushtruar të njëjtat të drejta që ligjvënësi, për shkak të interesit publik, ia ka rezervuar palëve të mësipërme, përfshirë edhe të drejtën e ankimit kundër vendimit të gjykatës që ka gjykuar çështjen në themel dhe ka vendosur për fajësinë ose jo të të pandehurve. Kërkuesi nuk ka arritur të provojë cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të interesit të tij nga vendimet objekt kundërshtimi të kësaj kërkesë, për rrjedhojë Kolegji vlerëson se nuk legjitimohet *ratione personae* për të kërkuar shfuqizimin e vendimeve objekt gjykimi. Në kushtet kur një nga kriteret paraprake nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë për shqyrtimin e kërkesës bëhet e panevojshme për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

16. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.